

AKT NORMATIV
Nr. 30, datë 27.9.2021

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA NË
MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME
AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i disa ndryshimeve

Miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama